



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN


Nr. 65 Prot.

Tiranë, më 25.11.2020

MIRATOHET

DREJTOR

Mimoza ÇULIQI



RREGULLORE E BRENDSHME

PËR MIRATIMIN E REVISTËS LETRARE

“LETRA NGA DIASPORA”

TIRANË

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja e funksionimit të revistës letrare “Letra nga diaspora” mbështetet në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike, i ndryshuar”, Ligjin Nr.16/2018 datë 5.4.2018 “Për Diasporën”, Ligjin Nr. 9616, datë 27.9.2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to” Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar , VKM-në Nr. 469, datë 26.7.2018, “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, VKM 188, date 13.03.2019, Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre”, VKM-në Nr.120 datë 27.01.1997 “Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor”, si dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen me veprimtarinë e këtij institucioni.

Neni 2

Parime të përgjithshme

1. Revista letrare “Letra nga diaspora” (më tej “Revista”) është botim i Qendrës së Botimeve për Diasporën (më tej “QBD”).
2. Drejtori i QBD-së vendos lidhje me institucionet e indeksimit ndërkombëtar dhe ka për detyrë rritjen e cilësisë të revistës për të realizuar sa më mirë promovimin e letërsisë shqipe të diasporës në nivel ndërkombëtar;
3. Editoriali i revistës përgatitet nga drejtori i QBD-së, nën autoritetin e të cilit revista botohet.
4. QBD ruan të drejtën ekskluzive të botimit të revistës.
5. Revista botohet 2 (dy) herë në vit.
6. Revista mbështetet mbi parimet e mëposhtme:
 - a. Respekton standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të katalogimit dhe autorësisë.
 - b. Revista botohet në shqip dhe anglisht.
 - c. Titulli i artikullit, abstrakti dhe fjalët kyçe paraqiten edhe në gjuhën shqipe dhe angleze.
7. Revista mban në kopertinë emrin dhe logon e QBD-së.
8. Revista pajiset me ISSN.

Neni 3

Qëllimi

1. Revista ka për qëllim të promovojë letërsinë shqipe të diasporës në nivel ndërkombëtar. Ajo synon të mbledhë vlerësimet letrare të autorëve shqiptarë dhe të informojë publikun në fushat e shkencave të komunikimit, kulturës dhe letërsisë.
2. Botimi i revistës nuk ka qëllim fitimprurës.

Neni 4

Struktura e revistës

1. Struktura e Revistës përbëhet nga:
 - a) Bordi letrar;
 - b) Kryeredaktori;
 - c) Redaksia.
2. Struktura e revistës propozohet nga drejtori i QBD-së dhe miratohet nga Këshilli Koordinues i QBD-së.
3. Në strukturën e revistës do të përfshihen shkrimtarë dhe poetë të spikatur të fushave dhe përfaqësues të institucioneve të fushës së letërsisë dhe artit.
4. Anëtarët e bordit letrar dhe kryeredaktori propozohen nga drejtori i QBD-së dhe miratohen nga këshilli koordinues i QBD-së.
5. Anëtarët e bordit letrar dhe kryeredaktori shkarkohen nga organi që i ka emëruar në rastet e mëposhtme:
 - a. dorëheqje nga pozicioni i caktuar;
 - b. neglizhencë në kryerjen e detyrave të ngarkuara;
 - c. dënim me vendim të formës së prerë të gjykatës penale,
 - d. për arsye madhore.
6. Në rastin e shkarkimit të anëtarëve të redaksisë dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm do të zbatohen kushtet e përcaktuara në kontratat përkatëse.

Neni 5

Bordi letrar

1. Bordi letrar i revistës ka funksion këshillimor dhe vendimmarrës.
2. Bordi letrar mbledhet çdo 4 (katër) muaj, 3 (tri) herë në vit. Në raste të veçanta, bordi letrar mbledhet edhe me kërkesën e drejtorit të QBD-së.
3. Bordi letrar përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë.
4. Në mbledhjen e bordit letrar miratohen:
 - a. Rubrikat e përmbajtjes së revistës.
 - b. Aktivitetet në funksion të përmbajtjes së revistës.
5. Bordi letrar këshillon dhe orienton kryeredaktorin në lidhje me përmbajtjen e revistës.
6. Mandati i anëtarit të Bordit letrar të revistës është 4 (katër) vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 6

Kryeredaktori i Revistës

1. Detyrat e kryeredaktorit revistës janë:

- a. Garanton cilësinë e përmbajtjes së shkrimeve dhe imazhit e saj, në përputhje me kriteret e të botimit të revistës.
- b. Në bashkëpunim me drejtorin e QBD-së, i cili përgatit editorialin e revistës, harton tematikën për çdo numër të revistës.
- c. Përgjigjet për cilësinë e shkrimeve të revistës.
- d. Komunikon me autorët dhe redaktorët për mbarëvajtjen e proceseve realizuese të Revistës
- e. Miraton variantin përfundimtar të botueshëm të revistës.
- f. Përcakton pranimin dhe/ose mospranimin e dorëshkrimeve të artikujve, shoqëruar me argumentimet (për vendimet e mosprimit apo të primit me kusht).
- g. Garanton nivelet e respektimit të së drejtës së autorit për secilin artikull dhe për revistën në tërësi.
- h. Vlerëson dorëshkrimet e dorëzuara për botim për përmbajtjen e tyre.
- i. Në bashkëpunim me drejtorin e QBD-së vendos ura bashkëpunimi me komunitetet letrare, brenda apo jashtë vendit, me të cilat përputhen interesat dhe fushat që mbulohen nga rubrikat e përmbajtjes së revistës.
- j. Harton raportin vjetor në lidhje me vlerësimin e performancës së revistës, perspektivat në vijim dhe drejtimet që duhen marrë në konsideratë.
- k. Zbaton vendimet e bordit letrar të revistës për angazhim me kohë të pjeshme të bashkëpunësorëve të jashtëm në bashkëpunim me Drejtorin e QBD-së
- l. Thërret bordin letrar të revistës, në prani të drejtorit të QBD-së, në fillim të vitit kalendarik, për të përvijuar me vendimmarrjen mbi ciklin e veprimtarive për numrin e ardhshëm të revistës.
- m. Bashkëpunon me drejtorin e QBD-së për sigurimin e botimit të revistës në kohë.

2. Mandati i zgjedhjes së kryeredaktorit të revistës është 4 vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 7 **Redaksia**

1. Redaksia e revistës përbëhet nga bashkëpunësorë të jashtëm të revistës të cilët janë:
 - Redaktori i revistës
 - Gazetari i kulturës
 - Ilustruesi i revistës
2. Bashkëpunësorët e jashtëm të revistës do të jenë ekspertë, të cilët do t'i nënshtrohen procedurave të konkurrimit publik nga një komision vlerësimi, i përcaktuar sipas rregullores së brendshme të veprimtarisë botuese të QBD-së.
Bashkëpunësorët e jashtëm do të kontraktohen nga Drejtori i QBD-së për detyra të veçanta në përputhje me kushtet e kontratës së shërbimit. Në rastin e kontraktimit apo

shkarkimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm do të zbatohen kushtet e përcaktuara në kontratat përkatëse bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

3. Bashkëpunëtorët e jashtëm të angazhuar në kuadër të menaxhimit të revistës duhet të plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:
 - Të kenë mbaruar arsimin e lartë në ciklin/profilin përkatës;
 - Të kenë përvojë pune mbi 5 vjet në ciklin/profilin përkatës;
 - Të kenë përvojë në redaktimin shkencor dhe letrar të dokumentacioneve;
 - Të njohin informacionin, strukturën dhe përmbajtjen e Revistës Letrare;

Neni 8 **Redaktori**

1. Redaktori i revistës kontraktohet kur është e nevojshme si bashkëpunëtor i jashtëm *ad hoc* i revistës, sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 7, pika 2, në këtë rregullore dhe është përgjegjës për procesin e shqyrtimit të revistës nga pikëpamja redaktoriale sipas standardit të gjuhës shqipe dhe rregullave të drejtshkrimit të saj.
2. Redaktori vlerëson variantin përfundimtar të botueshëm të revistës sipas kriterëve të shkrimit dhe llojeve të tij. Ai kryen verifikimin e informacionit, strukturës dhe përmbajtjes së revistës dhe ndihmon për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës.

Neni 9 **Gazetari i kulturës**

1. Gazetari i kulturës kontraktohet kur është e nevojshme si bashkëpunëtor i jashtëm *ad hoc* i revistës, sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 7, pika 2, në këtë rregullore dhe është përgjegjës për procesin e shqyrtimit të revistës nga pikëpamja redaktoriale letrare.

Neni 10 **Ilustruesi**

1. Ilustruesi i revistës është përgjegjës për pamjen vizive dhe organizimin e brendshëm (dizajnin) e shkrimeve që do të botohen në numrin e radhës së revistës
2. Ilustruesi i revistës do të kontraktohet kur është e nevojshme si bashkëpunëtor i jashtëm *ad hoc* i revistës, sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 7, pika 2 në këtë rregullore.

Neni 11 **Autorët**

1. Autor është çdo person fizik ose grup personash fizikë që krijojnë një vepër, produkt intelektual origjinal, pavarësisht nga forma dhe mënyra e të shprehurit. Në mungesë të provave për të kundërtën, çdo individ ose grup individësh, emri i të cilit shfaqet mbi ballinën

- e një vepre, cilado qoftë mënyra e shfaqjes, prezumohet autor i veprës.
2. Autori nënshkruan kontratë botimi me QBD duke përfituar shpërblimin financiar të punës krijuese sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
Në mbështetje të Ligjit nr. 35/2016 *Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to*, në kontratën e botimit që autori/autorët nënshkruajnë me QBD-në përcaktohet/parashikohet kohëzgjatja e të drejtave të botimit të Entit Botues.
 3. Autorësia dhe çështjet e lidhura me të, zgjidhen në përputhje me parashikimet e rregullores së brendshme të veprimtarisë botuese të QBD-së.

Neni 12

Etika në botime

Pranimi i kontributeve shikimore për botim në revistë bëhet në përputhje me praktikat më të mira të etikës së botimit, duke respektuar kërkesat në lidhje me autorësinë dhe ndalimet për dorëzimin e dyfishtë, plagjiaturën, manipulimin e figurave dhe konfliktin e interesit.

Neni 13

Konflikti i interesit

Çështjet e konfliktit të interesit do të adresohen dhe zgjidhen në përputhje me Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar.

Neni 14

Thirrja për artikuj dhe kontribute letrare

1. Thirrja për botimin e artikujve letrarë dhe kontributeve të tjera të parashikuara në numrin e revistës propozohet nga drejtori i QBD-së dhe miratohet nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën. Thirrja për këto botime del çdo vit brenda muajit janar.
2. Nëse nuk përcaktohet ndryshe, në thirrjet përkatëse, propozimet për botim artikujsh dhe kontribute të tjera në revistë pranohen brenda datës 30 qershor të çdo viti. Thirrjet më sipër u dërgohen jo më pak se tri mediave kombëtare dhe paraqiten në faqen zyrtare të QBD-së.
3. Drejtori i QBD-së angazhohet që këto thirrje të mund të arrijnë një rreth autorësh sa më të gjerë vendas dhe ndërkombëtarë.

Neni 15

Shpërndarja

QBD shpërndan revistën brenda dhe jashtë vendit bibliotekave të sistemit kombëtar, për subjektet me interes arsimor e letrar në diasporën shqiptare, si dhe për individë të shquar të letërsisë shqiptare, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e veprimtarisë botuese së QBD-së.

Neni 16
Marrëdhëniet financiare

1. Marrëdhëniet midis revistës dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm të saj rregullohen përmes një kontrate tip, e cila mban në konsideratë misionin dhe qëllimin e botimit të revistës.
2. Masa dhe format e shpërblimit të autorëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm të revistës përcaktohen në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 17
Copyright-i i botuesit dhe i autorit

1. Pas nënshkrimit të kontratës së botimit të artikullit ose punimit letrar dhe shpërblimit të autorëve, QBD zotëron të drejtën ekskluzive sipas Ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”.

Neni 18
Shtypja e Revistës

QBD është organi përgjegjës për organizimin e procedurave përkatëse për të realizuar botimin e revistës, sipas përcaktimeve në rregulloren e veprimtarisë botuese së QBD-së.

Neni 19
Ndryshimi apo shfuqizimi

Ndryshimet dhe shtesat e nevojshme në këtë rregullore bëhen me propozim të drejtorit të QBD-së dhe miratohen nga këshilli koordinues i QBD-së.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Rregullorja e revistës hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI

Mimoza HYSA GULIQI

